



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 27, Datë 22.02.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SH.P.K. PËR LËSHIMIN E  
GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA  
IMPIANTI “PARKU FOTOVOLTAIK EZ-5 SOLAR PARK”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 7 dhe 11 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, i ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.02.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 29/5prot., datë 15.02.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për lëshimin e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti “Parku Fotovoltaik EZ-5 Solar Park””,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2513 prot, datë 14.12.2023, shoqëria “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për lëshimin e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti “Parku Fotovoltaik EZ-5 Solar Park”, për vitin 2023.
- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresat nr. 29 prot., datë 04.01.2024 dhe nr. 29/2 prot., datë 25.01.2024, për plotësimin e informacionit të munguar të këtij aplikimi.
- Shoqëria ka kthyer përgjigje përkatësisht me shkresat nr. 29/1 prot., datë 08.01.2024, dhe nr. 29/3 prot., datë 29.01.2024, duke plotësuar dhe informacionin e munguar.
- Me shkresën nr. 29/4 prot., datë 02.02.2023, ERE i është drejtuar Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike

faktike të prodhuar nga ky impianti, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, numrin serial të aparatit matës dhe leximin e datës 1 të secilit muaj të kësaj periudhe.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 29/5 prot., datë 12.02.2024, OSSH sh.a. ka dhënë informacionin përkatës për aparatet matës dhe ka paraqitur në formë tabelare sasinë faktike të energjisë së injektuar në rrjetin e shpërndarjes nga impianti “Parku Fotovoltaik EZ-5 Solar Park”, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, e ndarë në muaj.
- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar.
- Për sa më sipër vlerësohet dhënia e Garancisë së Origjinës për energjinë e prodhuar nga impianti “Parku Fotovoltaik EZ-5 Solar Park”, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, sipas sasive të dhëna nga OSSH sh.a, duke iu referuar dhe përcaktimeve të pika 11.2 dhe 11.3 të Rregullores, ku parashikohet se Garancia e Origjinës lëshohet për një njësi të energjisë elektrike 1 MWh.
- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 22, pikës 5 të ligjit nr. 24/2023: *Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti “Parku Fotovoltaik EZ-5 Solar Park”, i shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, e ndarë sipas muajve, si vijon:

a)	Janar	725	MWh
b)	Shkurt	1.131	MWh
c)	Mars	1.404	MWh
d)	Prill	1.808	MWh
e)	Maj	1.958	MWh
f)	Qershor	2.106	MWh
g)	Korrik	2.480	MWh
h)	Gusht	2.131	MWh
i)	Shtator	1.527	MWh
j)	Tetor	1.195	MWh
k)	Nentor	797	MWh
l)	Dhjetor	741	MWh

2. Sasia totale vjetore e energjisë elektrike e prodhuar nga ky impiant është 18,003 MWh.
3. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**